



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 380

Lënda: Pediatri

PROGRAMI I LËNDËS									
Pediatri									
Titullari i lëndës:	Aurela Saliaj Prof. Ascoc. Phd në Pediatri _____								
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	24	4	0	2	75	125	200
Tipologjia e lëndës	Lëndë karakterizuese								
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda	Viti III, Semestri II								
Lloji i lëndës	E detyruar								
Programi i studimit	Bachelor në "Infermieri Mami"								
Kodi i lëndës	INF 380								
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës	aurela.dai@univlora.edu.al								

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri profesionale në fushën e perinatologjisë dhe patologjive pediatrike. Perinatologjia studion kujdesin shëndetsor për fëmijën e porsalindur dhe trajtimin e problemeve që mund të shfaqen gjatë periudhës neonatale. Gjithashtu studentët do të mësohen të njohin dhe të trajtojnë sëmundjet më të shpeshta të moshës fëmijënore.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">▪ Njohja me faktorët riskantë të shëndetit të fëmijës gjatë periudhës perinatale.▪ Paraqitja e vlerësimit klinik të neonatit.▪ Njohja me patologjitë e neonatit dhe të fëmijës sipas trakteve dhe sistemeve, si dhe me strategjitë e menaxhimit të tyre.
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">☞ Të diagnostikojnë patologjitë kryesore të periudhës perinatale.☞ Të diagnostikojnë klinikisht patologjitë kryesore pediatrike.☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të fëmijëve me patologji pediatrike.☞ Të prezantojë raste klinike tërësore: nga etiologjia tek plani i asistencës

KONCEPTET THEMELORE

1. Pediatria është dega e shkencave mjekësore që trajton kujdesin shëndetësor gjatë fëmijërisë (nga konceptimi në adoleshencë) në shëndet dhe sëmundje. Ajo merret me parandalimin, promovimin dhe kujdesin kurativ dhe rehabilitues tek fëmijët. Qëllimi i kujdesit perinatal/pediatrik është të reduktojë sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë fetale e neonatale / pediatrike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

- Termi "Pediatri" vjen nga Greqishtja: Pedia – fëmijë dhe Iatrike-trajtim. Pediatria është sinonimi i shëndetit të fëmijës.
- Periudha perinatale nënkupton 'kohën për-rreth lindjes së bebit'.
- Fëmijët janë konsumuesit më të mëdhenj të kujdesit shëndetësor, sepse janë shumë të ndjeshëm ndaj problemeve të shumta shëndetësore.
- Kujdesi i sotëm pediatrik përcakton shëndetin e nesërm të shoqërisë dhe të kombit.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Kapitulli I: Perinatologjia Tema 1 – Prezantimi i lëndës. Hyrje në neonatologji. Periudha intrauterine. <i>Qëllimi i kujdesit perinatal është të reduktojë sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë fetale e neonatale. Periudha intrauterine është periudha nga momenti i konceptimit të zigotës e derisa fetusit del nga barku i nënës.</i> Tema 2 - Metodën e vlerësimit të fetusit <i>Njohja me metodat e vlerësimit të gjendjes fetale.</i> Tema 3 - Patologjia fetale. Vuajtja fetale akute dhe kronike. <i>Njohja me faktorët e lidhur me nënën që ndikojnë mbi embrionin, fetusin apo të porsalindurin dhe pasojat mbi produktin e konceptimit.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS.	⁽¹⁾ fq.3-7	Leksion 1 orë
	Tema 4 – Përshtatja e fetusit me jetën ekstrauterine <i>Ndodhitë që ndërhyjnë në momentin e lindjes për të lejuar një kalim harmonik nga jeta ujore (brenda mitrës/ e varur nga nëna), në atë autonome (jashtë mitrës / ajrore).</i> Tema 5 - Pritja e neonatit normal. Ekzaminimi klinik i neonatit në term (anamneza). <i>Objektivat e pritjes së neonatit normal (AGA, term, pa patologji). Marrja e anamnezës së tij.</i> Tema 6 - Ekzaminimi klinik i neonatit në term (ekzaminimi fizik dhe neuromotor) <i>Në periudhën neonatale ekzaminimi klinik, si në çdo moshë tjetër, duhet të jetë i plotë e i hollësishëm. Ai përfshin vlerësimin e gjendjes fizike dhe neuro-motore të të porsalindurit.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS.	⁽¹⁾ fq.8-11 ⁽¹⁾ fq.12-17	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 4 orë</i>
	II.	Tema 7 – Vlerësimi i zhvillimit fizik të neonatit bazuar mbi peshën trupore dhe moshën e shtatzanisë. Fëmija IUGR. <i>Mënyra e vlerësimit të zhvillimit fizik të neonatit. Diagnostikimi dhe problemet e pritshme të të porsalindurve IUGR.</i> Tema 8 –Fëmija LGA, Preterm dhe Postterm. <i>Diagnostikimi dhe problemet e pritshme të të porsalindurve LGA, Preterm dhe Postterm.</i> Tema 9 –Përcaktimi i moshës gestacionale. Neonati i shëndoshë-në rrezik-i sëmurë. <i>Përcaktimi i moshës pediatrike të barrës: bëhet në bazë të kritereve fiziologjike dhe neurologjike të maturimit dhe na tregojnë pjekurinë reale të fëmijës. Vlerësimi nëse neonati është në gjendje të mirë, është në rrezik për të bërë ndonjë patologji apo është i sëmurë.</i>	⁽¹⁾ fq.18-21 ⁽¹⁾ fq.22-27 ⁽¹⁾ fq.30-38
III.		⁽¹⁾ fq.39-46 ⁽¹⁾ fq.47-52 ⁽¹⁾ fq.53-56	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS.		<i>Praktikë 4 orë</i>
IV.	Tema 10 – Reanimacioni neonatal. <i>Rrjedhajat e asfiksisë tek i porsalinduri dhe plani i trajtimit të saj.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.57-64</i>	Leksion 1 orë
	Tema 11 –Detresi respirator neonatal. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Detresit respirator të të porsalindurit.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.67-70</i>	Leksion 1 orë
	Tema 12 –Ikteri neonatal. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hiperbilirubinemisë së të porsalindurit.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.71-77</i>	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS		<i>Praktikë 4 orë</i>
V.	Tema 13 – Hipotermia tek neonati. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hipotermisë së të porsalindurit.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.78-83</i>	Leksion 1 orë
	Tema 14 –Hipoglicemia neonatale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hipoglicemisë së të porsalindurit.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.85-87</i>	Leksion 1 orë
	Tema 15 –Infeksionet neonatale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Infeksioneve të të porsalindurit.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.88-90</i>	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS		<i>Praktikë 4 orë</i>
VI.	Kapitulli III: Patologjitë pediatrike		
	Tema 16 – Rinofaringiti akut. Laringiti akut <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të patologjive të traktit të sipër respirator.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.205, 208-209</i>	Leksion 1 orë
	Tema 17 - Tonsiliti akut. Otiti i mesëm. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Tonsilitit, Bronkitit.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.206-207, 210</i>	Leksion 1 orë
	Tema 18 - Bronkiti. Bronkioliti. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Bronkitit, Bronkektazisë.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.211-215</i>	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
VII	Tema 19 – Asthma bronkiale <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Asthmës bronkiale.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.216-219</i>	Leksion 1 orë
	Tema 20 -Pneumonitë virale dhe bakteriale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Pneumonive.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.220-224</i>	Leksion 1 orë
	Tema 21 - Fibroza kistike. Bronkektazia. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Mukoviscidozës dhe Bronkektazisë.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.227-231</i>	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
VI	Tema 22 – Sëmundjet infektive dhe Vaksinimi. <i>Llojet, kalendari dhe përdorimi i vaksinave.</i> Tema 23 -Difteria. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Difterisë.</i> Tema 24 –Tetanozi. Pertusi. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Tetanizit dhe Pertusit.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.	⁽¹⁾ <i>fq.232-236</i> ⁽¹⁾ <i>fq.237-239</i> ⁽¹⁾ <i>fq.240-244</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 4 orë</i>
IX.	Tema 25 – Meningitet bakteriale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Meningiteve dhe Meningokoksemisë.</i> Tema 26 –Tuberkulozi pulmonar. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të TBC.</i> Tema 27 –Salmoneloza. Shigeloza. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të sëmundjeve diarreike.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.	⁽¹⁾ <i>fq.245-249</i> ⁽¹⁾ <i>fq.250-253</i> ⁽¹⁾ <i>fq.240-244</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 4 orë</i>
X.	Tema 28 – Diarretë dhe dehidrimi. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të dehidrimit.</i> Tema 29 –Parotiti. Variçela. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Parotitit dhe Variçelës.</i> Tema 30 –Fruthi. Rubeola. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Fruthit dhe Rubeolës.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.	⁽¹⁾ <i>fq.258-263</i> ⁽¹⁾ <i>fq.280-283</i> ⁽¹⁾ <i>fq.284-286</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 4 orë</i>
XI.	Tema 31 – Poliomieliiti. Hepatitet virale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Poliomielitit dhe Hepatiteve.</i> Tema 32 –Parazitizat. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Parazitizave.</i> Tema 33 –Ethja reumatizmale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Ethes reumatizmale.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.	⁽¹⁾ <i>fq.287-291</i> ⁽¹⁾ <i>fq.299-303</i> ⁽¹⁾ <i>fq.304-307</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 4 orë</i>
XII	Tema 34 – Veset e fituara dhe të lindura të zemrës. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Veseve kardiake.</i> Tema 35 –Diabeti i sheqerit. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Diabetit dhe ketoacidozës.</i> Tema 36 –Hypotiroza. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hypotirozës.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.	⁽¹⁾ <i>fq.308-315</i> ⁽¹⁾ <i>fq.320-326</i> ⁽¹⁾ <i>fq.327-329</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 4 orë</i>
XII	Tema 37 – Infeksionet e vjave urinare. Refluksi veziko-uretral. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Infeksioneve dhe Refluktit.</i> Tema 38 –Sindroma nefrotike dhe Glomerulonefriti akut. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Sindromës nefrotike dhe Glomerulonefriti.</i> Tema 39 –Anemitë. <i>Klasifikimi i anemive dhe diagnostikimi klinik e plani i trajtimit të</i>	⁽¹⁾ <i>fq.330-333</i> ⁽¹⁾ <i>fq.337-341</i> ⁽¹⁾ <i>fq.342-352</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<i>Anemisë Ferriprive.</i> Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XI	Tema 40 – Talasemitë. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Talasemive.</i> Tema 41 -Konvulsionet në fëmijëri. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Konvulsioneve febrile.</i> Tema 42 - Shock-u anafilaktik. Sindroma e vdekjes së papritur. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Anafilaksisë dhe SIDS.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.356-358</i> ⁽¹⁾ <i>fq.366, 370</i> ⁽¹⁾ <i>fq.381-383</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë		<i>Praktikë 4 orë</i>
XV	Tema 43 – Rakiti. Helmimet tek fëmijët. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të</i> Tema 44 – Gjenetika në Pediatri. <i>Diagnoza prenatale.</i> Tema 45 –Gjenetika në Pediatri. <i>Sindroma Doën, Turner.</i>	⁽¹⁾ <i>fq.384-389</i> ⁽¹⁾ <i>fq.399-403</i> ⁽¹⁾ <i>fq.405-408</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në pavionin e Pediatriisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kërkohe një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
KONTROLLI I VAZHUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provim i pjesshem	Java7-8	1-15	30 pike	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provim final	Fundi i semestrit	16=45	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjate semestrit	-	10 pikë	Prezantim njohurish me gojë	Demonstrim procedure në përkujdesjen infermiere
<p>*<i>Vlerësim i vazhduar</i> - Do të jetë në formën e një projekti klinik që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të patologjive pediatrike apo neonatale, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. Gjithashtu do të realizojnë dhe 3 plane kujdesi, bazuar në një format të gatshëm, për asistencën shëndetsore të hasur në praktikë. Një pjesë e</p>						



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	punimeve do të prezantohen dhe në PPT.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

LITERATURA	
Literatura bazë	“(1) ‘ Pediatria ’ A.Saliaj, 2017 (Fakulteti i Shëndetit Publik - UV) ISBN: 978-99956-95-89-7
Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none">○ ‘Pediatria’ D.Bebeci 2002 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)○ ‘E përdorim apo e keqpërdorim teknologjinë’ E.Tushe 2008 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)○ ‘Pediatria infermierore’ H.Jazo, 2005○ ‘Textbook of Paediatric’ Nelson, 2008○ ‘Maternity and Pediatric Nursing’ Thompson 2010

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritsmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëmior, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.
--	--